

JETA SHKENCORE**DRAMATURGU ETËHEM HAXHIADEMI NË FOKUSIN
E TRAJTIMEVE LETRARE E GJUHËSORE**

Me datën 25 qershor 2021, Departamenti i Studimeve Letrare i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë organizoi konferencën mbarëkombëtare me temë qendrore “Dramaturgu Etëhem Haxhiademi në fokusin e trajtimeve letrare e gjuhësore”, mbajtur në sallën “Aleks Buda”, pranë Akademisë së Shkencave, Tiranë.

Konferenca u hap me fjalën përshëndetëse të mbajtur nga prof. dr. Valter Memisha, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, në të cilën u nënvizua rëndësia e mbajtjes së kësaj konference shkencore me objektivin e nxjerrjes në dritë të një sërë kontributesh të dramaturgut, poetit dhe përkthyesit Etëhem Haxhiademi (1902-1965), veprat e të cilit u ekspozuan dhe në një variant ribotimi të përgatitur mjeshhtërisht nga Botimet Poeteka.

Duke përshëndetur konferencën, prof. as. dr. Evalda Paci nënvizoi pjesëmarrjen e kolegëve nga të tre departamentet e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, si dëshmi angazhimi ndaj një figure të rëndësishme për studimet albanologjike, por dhe atë të kolegëve nga disa universitete e qendra kërkimore-studimore, kontributet e të cilëve shënuan ndjeshëm mbarëvajtjen e kësaj konference.

Në seancën e parë të konferencës, të drejtuar nga prof. as. dr. Evalda Paci, prof. dr. Tomorr Plangarica, prof. dr. Laura Smaqi, u mbajtën kumtesa nga fusha themelore studimore që synonin të përaftronin kontribute qenësore të E. Haxhiademit në disa aspekte. Kumtoi akad. Shaban Sinani me temën “Faji” i të parilemit me sytë e Kainit në dy tragjedi të Haxhiademit”; prof. dr. Laura Smaqi me temën “Haxhiademi dhe procesi letrar mes dy luftërave botërore”; prof. dr. Tomorr Plangarica me temën “Prurjet teorike në shkencat e ligjërimit si mundësi për një qasje më shumë në leximin e vlerësimin e dramatikës së Haxhiademit”; dr. Arian Leka me temën “Tipare dhe veçori të estetikës dhe stilistikës së Etëhem Haxhiademit, vëzhguar përmes dëshmimeve të tij”; prof. as. dr. Evalda Paci me temën “Profili kompleks i një shqipëruesi përmes një varianti të Bukolikeve të Vergilit (1932)”.

Në seancat vijuese të mbajtura në ambientet e Akademisë së Shkencave u mbajtën kumtesa me interes që sollën këndvështrime me interes mbi krijimtarinë dhe shkrimtarinë e E. Haxhiademit.

Në seancën e drejtuar nga prof. dr. Tomorr Plangarica, dr. Arian Leka, dr. Virion Graçi kumtuan prof. as. dr. Abdulla Rexhepi, me temën “Turku si koncept i Tjetrit në veprën e Etëhem Haxhiademit”; dr. Virion Graçi, me temën “Figura e Gjergj Kastriotit- Skënderbeut në përthyerjen e zhanreve letrare të ndryshme; shikim krahasues i veprave “Kështjella” (I. Kadare), “Skënderbeu” (S. Godo) dhe “Skënderbeu” (E. Haxhiademi)”; prof. as. dr. Emin Z. Emini me temën “Aspekte dramatologjike dhe semiotike të personazhit si subjekt i diskursit në dramaturgjinë e E. Haxhiademit”; dr. Gëzim Puka me temën “Jehona e tragjedit të E. Haxhiademit në vështrimin e kritikëve të kohës”; dr. Durim Çaça me temën “Semiociteti i shoqërisë së diskursit (tragjedia “Skënderbeu” në një vështrim semiolinguistik)”; dr. Blerina Harizaj me temën “Transfigurimi dhe risemantizimi i miteve biblike në tragjedinë e Abelit të Etëhem Haxhiademit”; dr. Irma Sokoli me temën “Figura femërore në tragjedinë e Etëhem Haxhiademit”.

Në seancën paralele të drejtuar nga prof. as. dr. Merita Bruçi, prof. dr. Mimoza Priku; dr. Valbona Sinanaj, të mbajtur në sallën “Akademikët”, kumtuan prof. as. dr. Merita Bruçi me temën “Ethem Haxhiademi dhe Andon Zako Çajupi: dy fate botimi”; prof. dr. Mimoza Priku me temën “Patosi komunikativ në tekstin poetik të E. Haxhiademit”; dr. Valbona Sinanaj me temën “Theksi logjik dhe emocional në tragjedinë “Skënderbeu” të E. Haxhiademit”; dr. Silvana Leka me temën “Etëhem Haxhiademi- çështje të rikonceptimit të termave brenda (neo)klasicizmit”; Neli Naço me temën “Etëhem Haxhiademi dhe poezia. Veçori të “ideografisë” dhe stilit të tij poetik”; Eriena Lamaj me temën “Dimensione të injoruara dhe vlera të anashkaluara të një krijuesi dhe të veprës së tij letrare – artistike”; dr. Dea Temali-Karakaçi me temën “Stili gjuhësor në penën e Etëhem Haxhiademit”. Me organizimin e mbajtjen e kësaj konference u synua të hidhej dritë mbi një personalitet të letrave shqipe si Haxhiademi (1902-1965) që në dekadat e para të shekullit të kaluar iu kushtua krijimtarisë në gjini të rëndësishme letrare, por dhe shqipërimeve të kryeveprave të letërsisë klasike.

Evalda Paci